



Zyra Qendrore, Rr. Xh. Bush #26,10000 Prishtinë,Kosovë

FTESE PËR OFERTË

Ref no: T-0004-03-2023

Banka ProCredit i fton të gjitha kompanitë e interesuara të paraqesin ofertat e tyre për:

T-0004-03-2023- Renovimi i Objekteve te ProCredit Bank

Të interesuarit mund t'i kërkojnë dokumentet për aplikim prej datës **08.MARS.2023** në e-mail adresën [kos.Procurement\[@\]procredit-group.com](mailto:kos.Procurement[@]procredit-group.com).

Vërejtje:

- ProCredit Bank është deklarues i TVSH-së. Të gjitha çmimet e ofruara nga ofertuesit të cilët janë deklarues të TVSH-së duhet që ta listojnë ndarazi vlerën e TVSH-së, ndërsa ofertuesit që nuk janë deklarues të TVSH-së (bëjnë shitje të përjashtuar nga TVSH-ja), nuk duhet të listojnë ndarazi vlerën e TVSH-së.
- Për çmimet të cilat nuk e kanë të listuar TVSH-në ndarazi, do të nënkuptohet se vlera e TVSH-së është e përfshirë brenda çmimit.
- Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë tre muaj (120 ditë) nga dita e dorëzimit.
- Çmimet kuotohen në Euro (€).
- Ofertuesi duhet të paraqesë referenca të saj mbi shërbimet e ngjashme të ofruara më herët.
- ProCredit Bank mban të drejtën të kërkojë informata shtesë nga kompanitë e kualifikuara për ofertim.
- Kompania e përzgjedhur duhet të jetë e gatshme të ofrojë shërbimet në momentin që kërkohet nga ProCredit Bank,
- ProCredit Bank ka të drejtë të anulojë tenderin dhe/ose ndryshojë karakteristikat e tenderit dhe ti ftojë pjesëmarrësit për të sjellur sërish ofertat e tyre.
- ProCredit Bank ka të drejtë të zgjedh një apo më shumë fitues për këtë proces prokurimi, apo të ketë marrëveshje me më shumë se një kompani për të njëjtat shërbime/furnizime të cilat janë të parapara në këtë ftesë për ofertë.

Data e fundit për vizite në objektet e bankës dhe sqarime teknike është **17.03.2023**, ndërkaq data e fundit për dorëzimin e ofertës së kompletuar është **31.03.2023, ora 15:00h**.

Oferta duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur dhe e shënuar qartë **“T-0004-03-2023- Renovimi i Objekteve te ProCredit Bank”** në Zyrën Qendrore të Bankës ProCredit (Rr. Xhorxh Bush Nr. 26, 10000 Prishtinë).

Çdo pyetje shtesë rreth kësaj ftese për ofertë mund ta adresoni në:
[kos.procurement\[@\]procredit-group.com](mailto:kos.procurement[@]procredit-group.com)